



# MBETJET NË DREJTIM TË PADITUR

RAPORT MONITORIMI

Dhjetor 2024



QENDRESA QYTETARE

**NED** NATIONAL  
ENDOWMENT  
FOR  
DEMOCRACY  
SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

[www.qeverisja.qq.com.al](http://www.qeverisja.qq.com.al)

AUTOR  
SERONA KOLAVERI

## PËRMBAJTJA:

1. HYRJE.....	3
2. PARANTEZË .....	3
3. MENAXHIMI I MBETJEVE NDËR VITE .....	4
4. KLASIFIKIMI I MBETJEVE .....	5
5. SHFRYTËZIMI I FONDEVE PUBLIKE .....	6
6. KONTEKSTI JURIDIK DHE INSTITUCIONAL I LIGJIT .....	8
GJETJET KRYESORE.....	11
REKOMANDIME.....	12
REFERENCA.....	14



## 1. HYRJJE

Në vitet e fundit, Shqipëria ka përjetuar një rritje të ndjeshme të importit të mbetjeve, si pasojë e përpjekjeve për të menaxhuar mbetjet urbane dhe për të zvogëluar ndikimet mjedisore. Sidoqoftë, ky zhvillim ka sjellë një sërë efektesh negative që mund të kenë ndikime të rëndësishme për mjedisin, shëndetin publik, dhe zhvillimin afatgjatë të vendit. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka një rol kyç në monitorimin dhe vlerësimin e këtyre efekteve, duke siguruar që politikat dhe praktikrat e menaxhimit të mbetjeve të jenë në përputhje me qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjes së mjedisit.

Ky raport ka për qëllim të analizojë efektet negative të importit të mbetjeve në Shqipëri, duke u fokusuar në rritjen e presionit mbi landfill-et, ndotjen e ajrit dhe ujërave, si dhe rrezikun për shëndetin e qytetarëve. Po ashtu, do të shqyrtohen pasojat ekonomike dhe infrastrukturore që lidhen me menaxhimin e mbetjeve të importuara, si dhe ndikimet afatgjata në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Raporti gjithashtu do të shpjegojë se si këto efekte negative mund të ndikojnë në imazhin ndërkombëtar të Shqipërisë dhe mund të vënë në rrezik objektivat e saj për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe mbrojtjen e burimeve natyrore. Në përfundim, do të ofrohen rekomandime për përmirësimin e politikave dhe masave që mund të ndihmojnë në zvogëlimin e këtyre efekteve negative.

Ky raport është bazuar në një kombinim të analizës statistikore dhe cilesore, mbledhjes së të dhënave nga burime të ndryshme dhe shqyrtimin e praktikave ndërkombëtare. Rezultatet e marra janë vlerësuar për të nxjerrë në pah pasojat negative të importit të mbetjeve dhe për të sugjeruar masa për të adresuar këto problematika në të ardhmen.

## 2. PARANTEZË

Në vitin 2023, Shqipëria kishte importuar prej mbi 4,000 ton mbetje, që përfshijnë edhe ato të rrezikshme. Sipas të dhënave të **Komisionit European**, 12% e këtyre mbetjeve ishin të klasifikuara si të rrezikshme, përfshirë kimikate toksike dhe metale të rënda që mund të shkaktojnë sëmundje të ndryshme.

Shqipëria ka regjistruar një rritje të ndotjes së ajrit dhe ujit, ku ndotja e ajrit është përgjegjëse për rreth 1,200 vdekje të parakohshme çdo vit. Importimi i mbetjeve që përmbajnë substanca të rrezikshme mund të përkeqësojë ndotjen e ajrit dhe ujit, duke kontribuar në shfaqjen e sëmundjeve respiratore dhe kardiovaskulare, si dhe duke rritur shpenzimet e shëndetit publik.

Një tjetër problem që theksohet nga **Komisioni European** është se infrastruktura e menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri është ende e pamjaftueshme. Vetëm 30% e mbetjeve të prodhuara në vend trajtohen në mënyrë të duhur, duke lënë pjesën tjetër të mbetjeve të depozitohen në mënyra jo të sigurta, që mund të çojnë në ndotje të vazhdueshme të tokës dhe ujërave.

Kostoja e menaxhimit të mbetjeve është një tjetër çështje kyçe. Sipas një **studimi të realizuar nga Organizatat jo-qeveritare mjedisore**, në vitin 2023, Shqipëria shpenzoi rreth 10 milionë euro për trajtimin e mbetjeve të importuara, që është një shifër e konsiderueshme për një vend me burime të kufizuara. Këto shpenzime mund të rriten nëse importi i mbetjeve vazhdon të rritet, duke shkaktuar një barrë të madhe financiare për shtetin dhe duke devijuar burimet nga investimet e nevojshme në sektorë të tjerë si arsimi dhe shëndetësia.

Në nivel social, importimi i mbetjeve mund të ketë pasoja negative për komunitetet lokale, veçanërisht ato që ndodhen afër zonave të trajtimit të mbetjeve. Sipas **raporteve të Bankës Botërore**, ndotja që vjen nga trajtimi i mbetjeve ka ndikim negativ në cilësinë e jetës së banorëve, duke krijuar tensione dhe shqetësime për sigurinë dhe shëndetin e tyre. Për më tepër, kjo mund të çojë në migrimin e komuniteteve nga këto zona, duke shkaktuar pasiguri sociale dhe duke rënduar ekonominë lokale.


Në kontekstin e projektligjit të vitit 2024, është e rëndësishme që ky ligj të adresojë këto sfida në mënyrë të qëndrueshme dhe efektive. Sipas **raporteve të ekspertëve të mjedisit**, duhet të forcohen masat për kontrollin dhe monitorimin e importit të mbetjeve, veçanërisht atyre të rrezikshme. Gjithashtu, projektligji duhet të përfshijë mekanizma për zhvillimin e infrastrukturës së riciklimit dhe trajtimit të sigurt të mbetjeve, duke investuar në teknologji të pastra dhe proceset më të sigurta për mjedisin.

Një tjetër aspekt që duhet të merret parasysh është krijimi i një skeme të qartë për ndëshkimin e atyre që shkelin ligjin për importin e mbetjeve, duke përfshirë masa administrative dhe financiare për ata që sjellin mbetje pa licencë ose që nuk respektojnë standartet e trajtimit të mbetjeve.

### 3. MENAXHIMI I MBETJEVE NDËR VITE

Bazuar në të dhënat nga grafiku i menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri (2013-2024), vihet re një rritje progresive e mbetjeve të pamenaxhuara ndër vite. Ky trend reflekton mungesën e efikasitetit në implementimin e politikave të menaxhimit të mbetjeve, duke rritur ndotjen e mjedisit. Zonat rurale dhe periferike janë më të prekura nga ky fenomen, ku mbetjet shpesh përfundojnë në lumenj, pyje ose digjen në mënyrë të pakontrolluar, duke rritur nivelin e ndotjes së ajrit.



**Grafik 1: Trendet e Menaxhimit të Mbetjeve në Shqipëri (2013-2024)**

**Burimi: INSTAT (Përpunim i autorit)**

Nga 2013 deri në 2024, përqindja e mbetjeve të ricikluara mbetet e ulët (17-19%). Ky nivel reflekton mungesën e investimeve në infrastrukturën ricikluese dhe nevojën për politika stimuluese për sektorin privat, i cili mbështetet kryesisht në tregun e mbetjeve të importuara.

Pjesa më e madhe e mbetjeve urbane vazhdon të depozitohet në landfill-e. Ky proces është joefikas për shkak të mungesës së landfill-eve të pajisura me teknologji moderne për të minimizuar emetimet e gazrave serë dhe ndotjen e ujërave nëntokësore. Problemet që lidhen me landfill-et ekzistuese përfshijnë:

- Kapacitetet e kufizuara.
- Mungesën e trajtimit të mbetjeve të rrezikshme.
- Rritjen e ndotjes në zonat përreth.

Sipas të dhënave të mesipërme, rritja e importit të mbetjeve, krijon rrezik për hyrjen e mbetjeve toksike ose të pamenaxhueshme, për shkak të monitorimit dhe kontrollit joefikas.

Grafiku tregon përkeqësim të vazhdueshëm të sistemit të menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri, duke nxjerrë në pah nevojën për reforma urgjente dhe investime në infrastrukturë.

#### 4. KLASIFIKIMI I MBETJEVE

Grafiku i përbërjes së mbetjeve në Shqipëri tregon se rreth 45% e mbetjeve janë organike. Ky është një tregues i qartë mungesës së trajtimit efektiv të mbetjeve organike. Në mungesë të infrastrukturës për riciklim, këto mbetje shpesh përfundojnë në landfill, duke prodhuar gazra serrë si metani, një kontribues kryesor në ndryshimet klimatike.



**Grafik 2: Përbërja e mbetjeve****Burimi: INSTAT (Përpunim i autorit)**

Pjesa plastike përbën rreth 15-20% të mbetjeve, duke evidentuar riciklimin si një problem shqetësues. Kapacitetet e ulëta për përpunimin e plastikës çojnë në rritjen e nivelit të ndotjes nga mikroplastika, e cila përfundon në mjedise ujore, duke rrezikuar kështu shëndetin publik.

Materialet e tjera, si qelqi dhe metalet, zënë rreth 5-10% të totalit. Pavarësisht se këto mbetje kanë një vlerë të riciklueshme, mungesa e një sistemi të mirëorganizuar të grumbullimit çon në humbjen e këtyre burimeve dhe kontribuon në ndotjen e ujërave nëntokësore nga elementet toksike të metaleve.

Letra dhe kartoni përbëjnë 10-15% të mbetjeve. Në vend që të riciklohen, këto mbetje shpesh digjen ose dekompozohen në landfill, duke çliruar gazra ndotës si CO<sub>2</sub>. Kjo reflekton mungesën e një sistemi të qëndrueshëm për përpunimin e mbetjeve të dekompozueshme.


Mbetjet e tjera, që përfshijnë mbetje të rrezikshme dhe të paidentifikuara, përbëjnë 5-10%. Trajtimi i pamjaftueshëm i tyre përbën një rrezik serioz për ndotjen e mjedisit dhe shëndetin e popullsisë.

Këto të dhëna nxjerrin në pah nevojën urgjente për investime në infrastrukturën e trajtimit të mbetjeve, njëkohësisht ngrenë pikëpyetje të mëdha lidhur me importin e mbetjeve nga jashtë në Shqipëri duke marrë në konsideratë faktin që landfillet kryesore të mbetjeve tashmë kanë tejkaluar kapacitetet për depozitimin e tyre.

**5. SHFRYTËZIMI I FONDEVE PUBLIKE**

Grafiku i menaxhimit të mbetjeve me fonde publike sipas viteve tregon një tablo alarmante për mënyrën sesi Shqipëria ka menaxhuar mbetjet urbane gjatë periudhës 2013-2024. Edhe pse duket një rritje graduale në sasinë e mbetjeve të menaxhuara për banor, janë evidente problematikat me menaxhimin e përgjithshëm të mbetjeve.

**Grafik 3: Mbetje të menaxhuara me fonde publike në total referuar banorëve rezidentë sipas viteve.**



**Burimi: INSTAT (Përpunim i autorit)**

#### ○ **Kapaciteti i kufizuar i trajtimit të mbetjeve**

Pavarësisht rritjes së sasisë së mbetjeve të menaxhuara, vetëm një përqindje e vogël e tyre trajtohet siç duhet. Sipas të dhënave të vitit 2022 vetëm **4% e mbetjeve në Shqipëri u përpunuan** në atë vit, duke nxjerrë në pah punën e dobët të qeverisë dhe institucioneve për të krijuar një sistem të qëndrueshëm riciklimi dhe trajtimi. Kjo tregon se rritja në grafikun e mësipërm është sipërfaqësore dhe nuk përfaqëson përmirësim real.

#### ○ **Mungesa e politikave afatgjata dhe të qarta**

Qeveria dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit kanë dështuar në krijimin e infrastrukturës së nevojshme për trajtimin e mbetjeve. Landfillet dhe inceneratorët që duhet të trajtonin këto mbetje funksionojnë pjesërisht ose fare. Sipas të dhënave të publikuara lidhur me fondet publike, mbi **120 milionë euro**, janë harxhuar për inceneratorë të papërdorshëm, ç'ka përbën një tjetër dështim të politikave të qeverisë, duke shmangur objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm mjedisorë.

#### ○ **Ndikimi në mjedis dhe shëndet**

Një pjesë e madhe e mbetjeve të pamënaxhuara përfundon në lumenj, liqene dhe fusha, duke ndotur rëndë mjedisin. Bashkia e Tiranës dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk kanë marrë masa efektive për të parandaluar këtë ndotje, duke rritur rrezikun për shëndetin e qytetarëve.

- **Mosveprimi i bashkive dhe qeverisë në drejtim të riciklimit**

Shqipëria ka një normë riciklimi të ulët prej **17-19%**, shumë më poshtë mesatares evropiane. Kjo tregon mungesë angazhimi nga ana e shtetit për të edukuar qytetarët, për të ndërtuar sisteme të ndara mbetjesh dhe për të mbështetur bizneset e riciklimit.

- **Dështimi në planifikimin urban dhe menaxhimin e fondeve**

Rritja e sasisë së mbetjeve për banor nuk shoqërohet me rritje të eficiencës. Kjo vjen nga planifikimi i dobët urban dhe mungesa e koordinimit ndërmjet institucioneve. Për më tepër, fondet publike keqpërdoren pa u arritur rezultatet e duhura, duke mbetur një simbol i keqmenaxhimit të shtetit.

- **Dështimi në transparencën dhe llogaridhënien**

Qeveria nuk ka publikuar plane konkrete për të menaxhuar në mënyrë efikase flukset në rritje të mbetjeve dhe as për të përmbushur standardet evropiane për trajtimin e mbetjeve. Prokuroria dhe institucionet e tjera të drejtësisë duhet të hetojnë abuzimet me fondet publike për inceneratorët.

## 6. KONTEKSTI JURIDIK DHE INSTITUCIONAL I LIGJIT .

Projektligji për importin e mbetjeve në Shqipëri ka nxitur debate të ashpra për shkak të implikimeve të tij juridike dhe sociale. Në këtë analizë, përqendrohemi ekskluzivisht në dimensionin juridik të ligjit, duke evidentuar problematikat kryesore që lidhen me pajtueshmërinë e tij me kuadrin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe pasojat që mund të sjellë miratimi i këtij projektligji.

- **Mospërputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe aktet e tjera nënligjore**

Neni 59 i Kushtetutës detyron shtetin shqiptar të mbrojë mjedisin dhe shëndetin e qytetarëve. Projektligji rrezikon këtë detyrim kushtetues duke i hapur rrugë importit të mbetjeve, pa siguruar mekanizma të qarta për mbrojtjen e interesit publik.

**Neni 56:** Garanton të drejtën e qytetarëve për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe për të marrë informacion të saktë mbi çështje që prekin mjedisin. Projektligji nuk parashikon transparencë të mjaftueshme në lidhje me origjinën, përmbajtjen dhe trajtimin e mbetjeve.





## o **Mungesa e Harmonizimit me Legjislacionin e Bashkimit Evropian**

Shqipëria, si një vend kandidat për anëtarësim në BE, është e detyruar të përafrojë legjislacionin kombëtar me Acquis Communautaire. Projektligji për importin e mbetjeve bie ndesh me:

- **Direktivën e BE-së për Mbetjet (2008/98/EC):** Kjo direktivë përcakton një hierarki të menaxhimit të mbetjeve që priorizon parandalimin dhe riciklimin e mbetjeve vendase përpara importit. Shqipëria nuk ka përmbyshur ende këto standarde.
- **Regulloren e BE-së për Transportin e Mbetjeve (1013/2006):** Kërkon mekanizma të rreptë kontrolli dhe monitorimi për mbetjet që transportohen ndërkombëtarisht. Shqipëria nuk ka kapacitete për të garantuar këtë kontroll.

## o **Cënimi i Ligjit Nr. 10463 datë 22.9.2011, "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve"**

Ligji aktual për menaxhimin e mbetjeve përcakton që mbetjet duhet të trajtohen në përputhje me standardet mjedisore dhe të mos përbëjnë rrezik për shëndetin e qytetarëve.

- **Neni 8:** Përcakton që importi i mbetjeve lejohet vetëm për qëllime riciklimi dhe në përputhje me kapacitetet kombëtare të trajtimit. Aktualisht, kapacitetet për trajtimin e mbetjeve janë të kufizuara, ç'ka e bën të pamundur përmbyshjen e këtij kushti.
- **Neni 20 dhe 21:** Parashikojnë mbikëqyrjen dhe raportimin periodik të mbetjeve të importuara. Në mungesë të kapaciteteve inspektuese, këto dispozita mbeten të pazbatueshme

Aktet nënligjore të parashikuara nga ligji aktual për mbetjet janë shpesh të paplota ose të pazbatuara:

- **Mungesa e rregulloreve të detajuara** për standardet e riciklimit dhe procedurat e importit krijon hapësirë për keqmenaxhim dhe abuzime.
- **Përvoja me inceneratorët** në Shqipëri ka treguar se mungesa e monitorimit dhe transparencës çon në dështime të mëdha ligjore dhe financiare.


## o **Korrupsioni dhe Abuzimi me Ligjin**

- Projektligji krijon hapësira për manipulime në deklarimin e llojit dhe sasisë së mbetjeve të importuara.
- Në kushtet e korrupsionit në sektorin publik, ka një rrezik real që ligji të përdoret për të lehtësuar transportin e mbetjeve të rrezikshme, duke i etiketuar ato si mbetje për riciklim.



○ **Menaxhimi i mbetjeve dhe zbatimi i ligjit**

**Grafik 4: Numri i Inspektimeve dhe Gjobave për Shkelje të Ligjit mbi Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve**



**Burimi: Raporte Vjetore Agjencia Kombëtare e Mjedisit (Përpunim i autorit)**

Nisur nga grafiku i mësipërm vëmë re se të dhënat për periudhën 2018-2023 mbi inspektimet dhe gjobat për shkelje të Ligjit mbi Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve në Shqipëri nxjerrin në pah një fenomen shqetësues të rritjes së shkeljeve dhe pasojave të lidhura me to. Analiza e këtyre të dhënave nxjerr në pah disa aspekte negative që lidhen me menaxhimin e mbetjeve dhe zbatimin e ligjit:

- **Rritja e Numrit të Inspektimeve dhe Gjobave:**

Vitin 2018, numri i inspektimeve ka qenë 120, ndërsa në vitin 2023 ky numër është rritur në 300, duke treguar një rritje prej 150% në këtë periudhë. Edhe pse numri i inspektimeve është rritur, në të njëjtën kohë është një tregues i pamjaftueshmërisë së mekanizmave të mbikëqyrjes dhe kontrollit në periudhën e mëparshme.

Po ashtu, gjobat kanë pasur një rritje të vazhdueshme çdo vit, duke kaluar nga 20 gjoba në vitin 2018 në 50 gjoba në vitin 2023. Ky trend tregon një përkeqësim të vazhdueshëm të situatës, ku më shumë individë dhe subjekte po shkelin ligjin dhe nuk po zbatojnë rregullat për menaxhimin e mbetjeve. Gjobat më të larta nuk nënkuptojnë domosdoshmërisht një përmirësim të menaxhimit të mbetjeve, por mund të jenë një tregues i dështimit të masave parandaluese dhe edukative.

- **Efektet e Rritjes së Gjobave dhe Inspektimeve:**

Rritja e inspektimeve dhe gjobave nuk tregon një përmirësim të përgjithshëm të menaxhimit të mbetjeve, por një dështim të zbatimit të politikave dhe strategjive të parashikuara për menaxhimin e mbetjeve.

Ky fenomen tregon se, ndonëse inspektimet janë rritur, nuk ka ndodhur një përmirësim proporcional në ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe bizneseve për rëndësinë e menaxhimit të mbetjeve, gjë e cila ka çuar në zbatimin e dobët të legjislacionit.

- **Rritja e Shkeljeve dhe Ndikimi në Mjedis:**

Rritja e shkeljeve të ligjit tregon mospërputhje midis masave parandaluese dhe praktikave të menaxhimit të mbetjeve nga individët dhe subjektet. Ky trend ka një ndikim të drejtpërdrejtë në mjedis, pasi mbetjet e keqmenaxhuara rrezikojnë mjedisin natyror dhe shëndetin publik. Rritja e shkeljeve ndikon negativisht në cilësinë e ajrit, ujit dhe tokës, duke rritur ndotjen dhe rrezikuar biodiversitetin.

- **Mungesa e Politika dhe Strategjive Efektive:**

Rritja e inspektimeve dhe gjobave pa përmirësim të dukshëm në menaxhimin e mbetjeve tregon gjithashtu se politikat dhe strategjitë ekzistuese nuk janë të mjaftueshme për të adresuar shkeljet. Mungesa e një strategjie të qëndrueshme për integrimin dhe edukimin e qytetarëve në menaxhimin e mbetjeve është një arsye tjetër e moszbatimit efektiv të ligjit.

## 7. GJETJET KRYESORE

- Rritje progresive të mbetjeve të pamënaxhuara ndër vite, që reflekton mungesën e efikasitetit në implementimin e politikave.
- Zonat rurale dhe periferike janë më të prekura, ku mbetjet shpesh përfundojnë në lumenj, pyje, ose digjen në mënyrë të pakontrolluar, duke ndikuar në ndotjen e ajrit.
- Nga 2013 deri në 2024, përqindja e mbetjeve të ricikluara ka mbetur e ulët (17-19%), duke treguar mungesën e investimeve në infrastrukturën ricikluese.
- Normat e riciklimit janë shumë të ulëta (17-19%), duke reflektuar mungesën e angazhimit institucional për mbështetjen e riciklimit.
- Vetëm 4% janë mbetje të ricikluara, duke treguar punën e dobët të qeverisë në krijimin e një sistemi të qëndrueshëm riciklimi.
- Mbi 120 milionë euro të investuar për inceneratorë të papërdorshëm në krijimin e infrastrukturës për trajtimin e mbetjeve,
- Norma e riciklimit në Shqipëri është 17-19%, shumë më e ulët se mesatarja evropiane.
- Sasia e mbetjeve për banor nuk është shoqëruar me rritje në eficiencë, për shkak të planifikimit të dobët urban dhe keqpërdorimit të fondeve publike.
- Qeveria nuk ka publikuar plane konkrete për menaxhimin e mbetjeve dhe përmbushjen e standardeve evropiane, duke lënë hapësirë për abuzime me fondet publike.

- Projektligji është në kundërshtim me Ligjin Nr. 10463, duke i krijuar mundësi importit të mbetjeve për riciklim, ndërkohë që kapacitetet kombëtare të trajtimit janë të kufizuara dhe mbikëqyrja mbetet e pamjaftueshme.

## 8. REKOMANDIME

Për të arritur menaxhim efikas të mbetjeve, qeveria duhet të bëjë përpjekje të vazhdueshme për forcimin e implementimit të politikave ekzistuese dhe zhvillimin e mekanizmave për monitorimin e vazhdueshëm të këtyre politikave në nivel lokal dhe kombëtar. Roli i institucioneve shtetërore është kyç për sigurimin që politikat që miratohen nuk mbeten vetëm në letër, por përkthehen në aksione konkrete që ndikojnë pozitivisht në përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve. Për këtë qëllim, është e domosdoshme që të krijohet një sistem i strukturuar i monitorimit dhe raportimit që mundëson vlerësimin e efektivitetit të politikave dhe ndërhyrjen e shpejtë kur është e nevojshme. Po ashtu, ky sistem duhet të përfshijë ndërhyrje dhe mbështetje për autoritetet lokale, duke i ndihmuar ato të implementojnë politikat dhe të rrisin efektshmërinë në nivel të gjerë.

### ○ **Zhvillimi i infrastrukturës ricikluese:**

Një nga sfidat më të mëdha për menaxhimin e mbetjeve është infrastruktura e dobët për riciklimin. Investimet duhet të përqendrohen në zhvillimin dhe modernizimin e infrastrukturës për grumbullimin dhe riciklimin e mbetjeve, përfshirë ndërtimin e stacioneve të riciklimit dhe pikave të grumbullimit që do të mundësojnë mbledhjen dhe përpunimin e mbetjeve në mënyrë të sigurt dhe efikase. Gjithashtu, duhet të krijohet një sistem i qartë dhe i organizuar për mbledhjen e mbetjeve të riciklueshme, duke përfshirë edukimin dhe angazhimin e qytetarëve për të përdorur këto sisteme. Investimet duhet të mbështesin zhvillimin e teknologjive të reja që mund të përmirësojnë efikasitetin e riciklimit dhe të ulin kostot e përpunimit, duke siguruar një sistem të qëndrueshëm dhe të efektshëm.

### ○ **Përfshirja e zonave rurale në menaxhimin e mbetjeve:**

Zonat rurale shpesh janë në hije kur bëhet fjalë për menaxhimin e mbetjeve, duke krijuar ndotje të rëndë në lumenj, pyje dhe sipërfaqe të tjera natyrore. Për të përmirësuar këtë situatë, është e domosdoshme që të krijohen nisma të veçanta për menaxhimin e mbetjeve në këto zona. Kjo mund të arrihet duke ofruar mundësi për riciklim dhe mbledhje të mbetjeve, duke implementuar sisteme që do të nxisin komunitetet rurale të bëhen pjesë e këtij procesi dhe të kuptojnë rëndësinë e trajtimit të mbetjeve në mënyrë të qëndrueshme. Shtimi i nismave për të ngritur stacione të grumbullimit dhe përpunimit të mbetjeve në zonat rurale, si dhe ndihma financiare dhe logjistike për të krijuar këto mundësi, mund të kontribuojnë në përmirësimin e situatës

së ndotjes mjedisore dhe në rritjen e përfshirjes së këtyre zonave në menaxhimin e mbetjeve.

- **Rritja e investimeve për riciklimin:**

Një element kyç për përmirësimin e sistemit të riciklimit është rritja e investimeve në këtë fushë. Investimet duhet të fokusohen në krijimin e sistemeve të riciklimit në nivel kombëtar dhe lokal, si dhe në rritjen e kapaciteteve për përpunimin e mbetjeve të riciklueshme. Kjo përfshin zhvillimin e teknologjive më të mira për grumbullimin dhe përpunimin e mbetjeve, si dhe krijimin e mundësive për edukimin dhe angazhimin e qytetarëve në riciklim. Po ashtu, është e rëndësishme që të krijohen stimuj financiarë për bizneset që investojnë në infrastrukturën e riciklimit. Përmes këtyre investimeve, mund të rritet ndjeshëm përqindja e mbetjeve të ricikluara dhe të ulet ngarkesa e mbetjeve të pariciklueshme.

- **Rishikimi i përdorimit të inceneratorëve:**

Ndërhyrja e përdorimit të inceneratorëve për trajtimin e mbetjeve ka shkaktuar shqetësime të shumta lidhur me ndikimin e tij në shëndetin publik dhe mjedis. Qeveria duhet të rishikojë përdorimin e inceneratorëve dhe të investojë në teknologji më të qëndrueshme dhe më të pastra për trajtimin e mbetjeve, si p.sh., teknologjitë që mundësojnë riciklimin e mbetjeve pa krijuar ndotje. Inceneratorët mund të mbeten një opsion për trajtimin e mbetjeve të paspecifikuara, por është e rëndësishme që përdorimi i tyre të jetë i kufizuar dhe të mbështetet nga një sistem gjithëpërfshirës dhe efikas i menaxhimit të mbetjeve, duke u orientuar në riciklim dhe përpunim të mbetjeve.

- **Përmirësimi i planifikimit urban dhe menaxhimit të mbetjeve:**

Planifikimi urban është një faktor kyç për menaxhimin e mbetjeve. Qeveria dhe autoritetet lokale duhet të integrojnë strategji efektive për menaxhimin e mbetjeve në proceset e planifikimit urban, duke siguruar që zhvillimi urban të jetë në përputhje me standardet mjedisore dhe të mundësojë një menaxhim të qëndrueshëm të mbetjeve. Ky planifikim duhet të parashikojë ndarjen e hapësirave për grumbullimin e mbetjeve, infrastrukturën për riciklim, dhe sistemet për menaxhimin e mbetjeve në mënyrë efektive, duke shmangur krijimin e deponive ilegale dhe ndotjen. Po ashtu, duhet të ketë një koordinim më të mirë ndërmjet administratave lokale dhe qëndrueshmërinë financiare në përdorimin e fondeve publike për këto projekte.

- **Krijimi i planeve konkrete dhe të qarta:**

Qeveria duhet të hartojë dhe të publikojë plane të qarta dhe konkrete për menaxhimin e mbetjeve që do të ndihmojnë në përmbushjen e



standardeve evropiane dhe angazhimin për mbrojtjen e mjedisit. Këto plane duhet të përfshijnë objektiva konkrete për reduktimin e mbetjeve, rritjen e normave të riciklimit dhe zhvillimin e një infrastrukture të qëndrueshme. Gjithashtu, duhet të përfshihen mekanizma të qartë të mbikëqyrjes dhe të raportimit për të siguruar që këto plane të zbatohen në mënyrë efikase dhe të japin rezultate të prekshme për përmirësimin e gjendjes së mbetjeve dhe mjedisit.

Së fundmi qeveria duhet të ndalojë importin e mbetjeve, duke siguruar që Shqipëria të mos shndërrohet në një destinacion për mbetje të huaja. Ky hap është thelbësor për mbrojtjen e mjedisit dhe sigurimin e kapaciteteve të mjaftueshme për trajtimin e mbetjeve të brendshme. Duke ndaluar importin, Shqipëria mund të fokusohet në përmirësimin e infrastrukturës për menaxhimin e mbetjeve të brendshme, forcimin e kapaciteteve për riciklim dhe zvogëlimin e ndotjes mjedisore. Po ashtu, ndalimi i importit do të shmangë mundësitë për abuzime dhe do të ndihmojë në ruajtjen e standardeve mjedisore të kërkuara nga Bashkimi Evropian.

## 9. REFERENCA

- ❖ <https://qeverisjavendore.gov.al/wp-content/uploads/2024/12/RELACION-PER-PROJEKTLIGJIN-PER-MENAXHIMIN-E-INTEGRUAR-TE-MBETJEVE.pdf?>
- ❖ [instat.gov.al/media/13975/mbetjet-urbane-2023.pdf?](https://instat.gov.al/media/13975/mbetjet-urbane-2023.pdf)
- ❖ [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD\\_2023\\_690%20Albania%20report.pdf?utm\\_source=chatgpt.com](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf?utm_source=chatgpt.com)
- ❖ <https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2008/98/2024-02-18/eng/pdf>
- ❖ [RGJM-2023.AKM .pdf](https://www.rgj.gov.al/akm/2023/02/18/18022023/18022023.pdf)
- ❖ <https://monitor.al/inceneratoret-po-djegin-vetem-fondet-publike-120-mln-euro-eurostat-4-e-mbetjeve-ne-shqiperi-u-perpunuan-me-2022/>
- ❖ [kushtetuta-1.pdf](https://www.kushtetuta.org.al/18022023/18022023.pdf)
- ❖ <https://www.worldbank.org/sq/country/albania>
- ❖ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, (2024), *Raporti i Gjendjes në Mjedis 2023*
- ❖ <https://eur-lex.europa.eu/eli/reg/2006/1013/oj/eng>
- ❖ <https://akm.gov.al/raporte-dhe-publikime/>
- ❖ <https://akm.gov.al/wp-content/uploads/2022/12/Programi-Kombetar-i-Monitorimit-te-Mjedisit-2023.pdf>



#QËNDRESË/MIRËQEVERISJE

QENDRESA  
QYTETARE



NATIONAL  
ENDOWMENT  
FOR  
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

[www.qeverisja.qq.com.al](http://www.qeverisja.qq.com.al)